

P-EBT PËR FËMIJËT E SHKOLLËS PA



Transferimi Elektronik i Përfitimeve Pandemike (P-EBT) u jep familjeve para për të blerë ushqime për të kompensuar vaktet e humbura në shkollë për shkak të COVID.

Studentët kanë të drejtë për P-EBT për vitin shkollor 2021-22 nëse ata:

- Janë regjistruar për programin e vakteve shkollore falas dhe me çmim të reduktuar DHE
- Kanë pasur një ndërprerje të lidhur me COVID-in në mësim personalisht (si mungesat e 5 ditëve të shkollës me radhë ose mbylljet e klasave.)

Kontrolloni nëse fëmija juaj po merr një pagesë P-EBT duke vizituar portalin e prindërve* në cutt.ly/pebtportal

- Ju mund të shihni nëse fëmija juaj u kualifikua për një përfitim dhe nëse po, sa.
- Portali tregon **vetëm** detaje për pagesat që kanë filluar të dalin. Janë 3 periudha pagese për vitin shkollor 2021-22:
 - Pagesa 1: Mbulon vaktet e humbura nga Shtator-Nëntor 2021: përfitimet u dërguan në karta në fund të Qershorit.
 - Pagesa 2: Mbulon vaktet e humbura nga Dhjetor-Shkurt 2022: përfitimet filluan të dërgohen në karta në mes të Korrikut.
 - Pagesa 3: Mbulon vaktet e humbura nga Mars-Maj 2022: përfitimet do të fillojnë të dërgohen diku në Gusht.

**Vëmendje, portali nuk është miqësor me celularin.*

Përfitimet P-EBT do të vendosen në kartën tuaj SNAP EBT ose në kartën P-EBT të vitit të kaluar. Nëse fëmija juaj u kualifikua rishtazi dhe jo në SNAP, do t'ju dërgohet një kartë P-EBT. Nëse nuk keni një kartë P-EBT të vitit të kaluar, mund ta kërkonti një të tillë përmes portalit.

Shikoni anën tjetër për këshilla të zgjidhjes së problemeve

Çfarë duhet bërë nëse gjërat shkojnë keq:

Nëse ka pasur një problem me përfitimin P-EBT të fëmijës suaj, ju mundeni:

- Telefononi linjën direkte P-EBT në 1-877-343-0179. Keni në dorë informacionin e mëposhtëm kur telefononi:
 - Emrat e fëmijës(ve) tuaj
 - Data(t) e lindjes së fëmijës(ve)
 - Shkolla ose distrikti shkollor që ata ndjekin
 - Numri i telefonit i kontaktit
 - Email adresa e kontaktit
 - Email adresa aktuale
 - Një përshkrim i shkurtër i çështjes
 - Ditët specifike kur fëmija juaj ishte jashtë shkollës për shkak të COVID-19.
- Paraqisni një kërkesë përmes Formularit të Kërkimit P-EBT të DHS në <https://tinyurl.com/PEBTproblemPA>. Ju lutemi plotësoni sa më shumë informacion në formulë.

Mbani mend!

- Ju ende mund të merrni vakte verore **DHE** të merrni P-EBT.
- Marrja e P-EBT **nuk** ndikon në statusin e imigracionit.
- Marrja e asistencës mjekësore dhe ushqimore **nuk** ndikon në statusin e imigracionit.

Po nëse fëmija juaj nuk është regjistruar për vaktet e shkollës?

- PA po punon për të miratuar planin e saj Veror P-EBT nga USDA dhe synon t'i lëshojë ato përfitime në vjeshtë.
- Nëse nuk jeni regjistruar për Vakte Falas ose me Çmim të Reduktuar (FRP), nuk mund t'i merrni përfitimet. POR ende ia vlen të aplikoni!
- lotësoni një aplikim me shkollën tuaj ose në: compass.state.pa.us sa më shpejt të jetë e mundur. Nëse aplikoni deri më **31 Gusht**, mund të kualifikoheni të merrni pagesën Verore P-EBT këtë vjeshtë.

Për më shumë informacion, vizitoni:
justharvest.org/pebt-faq

PHILABUNDANCE
Driving hunger from our community

